



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety	25. 11. 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSDIK	5684/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.876/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën e datës 19.10.2021 me numër A.nr.876/2021 të pranuar me datë 21.10.2021 përmes Postës së Kosovës me nr.R.1810381, nga përfaqësuesi i autorizuar avokati me adresë Rruga "Sali Ceku", pa nr. Komuna e Ferizajt, për grupin e ankuesve:

dhe kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.876/2021 e datës 21.10.2021 të parashtruar nga ankuesit

dhe

A r s y e t i m

Ankuesit i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHFMU "Jeta e Re", në fshatin Greme, sipas kontratës së punës, e punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtore e SHFMU "Liman Reka "në fshatin Prelez i Muhaxhirëve, sipas kontratës së punës, punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtore e SHFMU "Jeronim De Rada", sipas kontratës së punës. i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHML "Shaban Hashani", sipas kontratës së punës, e punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHMU "Enver Topalli", fshatin Omuraj, sipas kontratës së punës, i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHML "Imri Halili", fshatin Gaçkë, sipas kontratës së punës, i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHMU "Ganimete Tërbeshi", sipas kontratës së punës, i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë Drejtor i SHML Agrobiznesi dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini", sipas kontratës së punës dhe i

punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitën Mësimdhënës i Shkollës së Mesme të Lartë e 'Agrobiznesit dhe Teknologjisë 'Zenel Hajdini'', sipas kontratës së punës, më datë 26.07.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Arsimit të Komunës së Ferizajt, me pretendim për njohjen e të drejtës së kompensimet të shujtës ditore, udhëtimit dhe licencim, dhe me datë 17.08.2021 kanë pranuar përgjigje me të cilën i është refuzuar kërkesa, dhe janë udhëzuar palët që të parashtrorjnë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave.

Ankuesit, pasi kanë pranuar përgjigjen e datës 17.08.2021 të kërkesës së tyre, më datë 26.08.2021 kanë parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Komunës së Ferizajt, mirëpo nuk kanë pranuar përgjigje.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit me datë 19.10.2021 kanë parashtruar ankesë përmes Postës së Kosovës me nr.R.1810381, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 21.10.2021 me numër protokollit 5113/2021 me pretendime ankimor për njohjen e të drejtës së kompensimet të shujtës ditore, udhëtimit dhe licencim. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.10.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje të ankuesve në Komunë të Ferizajt Drejtorin e Arsimit, të cilët me datë 10.03.2021 kanë dërguar përgjigjen me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Ferizajt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroj këto prova: Ankesën me numër protokollit 5113/2021 të regjistruar me numër A.nr.876/2021 të datës 21.10.2021 e parashtruar nga ankuesit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesve për Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Ferizajt e datës 26.07.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 17.08.2021; Ankesën e ankuesve e dërguar për Komisionin e Ankesave të datës 26.08.2021; Zarfën e datës 19.10.2021; Prokurën lidhur me autorizimin e datës 25.10.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.11.2021; Parashtrësë e datës 01.11.2021 e parashtruar nga ankuesit; Kontratë Pune Nr. 1764/2 e datës 22.11.2018; Licencë e mësimdhënësit e datës 01.12.2017; Lista e regjistrimit të mësimdhënësve e datës 06.04.2021 në SHFMU Jeta e Re; Diplomën e datës 22.05.2008 për ankuesin Lista e pagave e nëntorit 2019; Kontratë Pune Nr.590/4 e datës 19.09.2017; Licenca e mësimdhënësit e datës 05.09.2019; Diplomën e datës 22.07.2014; Kontratë Pune Nr. 528/2 e datës 25.08.2017; Listën e pagave dhjetor 2020; Certifikatën e datës 03.07.1995; Licencën e mësimdhënësit e datës 18.10.2021; Kontratë Pune me Nr. 317/2015 e datës 09.09.2015; Licencën e mësimdhënësit e datës 23.12.2021; Diplomën e datës 20.03.2006; Listën e pagave korrik 2019; Kontratë pune Nr. 1309/1 e datës 24.07.2018; Diplomën e datës 30.03.2011; Listën e pagave janar 2021; Regjistrim e mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë SHMU Kontratë Pune Nr. 528/3 e datës 25.08.2017; Diplomën e datës 13.03.2015; Licencën e mësimdhënësit e datës 10.12.2017; Listën e pagave prill 2021; Vërtetim i datës 25.05.2021;Kontratë Pune Nr. 159/2017 e datës 08.03.2017; Tabela e ditëve të punës për personelit e Shkollës Lista e pagave mars 2021; Licencën e mësimdhënësit e datës 21.05.2021; Diplomën e datës 12.03.1988; Kontratë Pune për mësimdhënës e datës 20.03.2015; Diplomë e datës 18.01.2011; Licencën e mësimdhënies e datës 14.09.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoje se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit:

sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e paragrafit 4 të nenit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, zyrtarët publikë të punësuar në administratën shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës... kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik, ku përcaktohet se: ***“Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”***, në këtë rast ankuesit sipas kontratave të punës janë të punësuar në sistemin arsimor në komunën respektive, rrjedhimisht pozitat e ankuesve në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë hyjnë në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik.

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, ku neni 67 paragrafi 6 i këtij ligji, ka bërë kategorizimin e nëpunësve të shërbimit publik si: ***“Nëpunësit e shërbimit kategorizohen në personelin drejtues, në personelin profesional dhe në personelin e brendshëm të shërbimeve të përbashkëta”***, kështu që meqë pozitat e ankuesve janë pozita të nëpunësve të shërbimit publik, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se e drejta e ankimit për nëpunësit e shërbimit publik është rregulluar me dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*** dhe neni 74 paragrafi 1 të këtij ligji, i cili përcakton: ***“Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës”***, ndërsa nëse pala është e pakënaqur me vendimin e organit të punësimit mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente siç parashihet me nenin 74 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.


Andaj, duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.876/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar avokat
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

